R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL

Nr. 4, datë 09.07.2026

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:17
Data e mbajtjes së mbledhjes : 09.07.2026
Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak
Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Zëvendëskryetari i Bashkisë z.Gentian Kallmi si dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Denisa Luarasi: Përshëndetje,
Të nderuar këshilltarë ! I nderuar zëvendëskryetar! Të nderuar të pranishëm, media !
Deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës për Këshillin Bashkiak Durrës. Në këtë mbledhje do të shqyrtojmë dhe do të miratojmë 19 projektvendime të propozuara nga kryetarja e bashkisë. Materialet ju janë vënë në dispozicion nga Sekretariati i Këshillit nëpërmjet email-it.
Dori, ju lutem prezencën.

Dorina Milja: Përshëndetje ! Fillojmë...
Ardian Muka ... ……deri tek…. Florian Tahiri…
36 këshilltarë në sallë.
V.O. *Dalin gjatë mbledhja Elisabeta Mataj, që rikthehet përsëri, Bledar Prizreni, Kontjana Kuçi dhe Zhuljeta Ngota..*

Denisa Luarasi: Faleminderit Dori.
Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen. Po kaloj në leximin e pikave të rendit të ditës.

Pika 1.	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN QERSHOR 2026
Pika 2.	PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2026-2030 NË BASHKINË DURRËS
Pika 3.	PËR MIRATIMIN E DISA SHTESAVE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 99, DATË 28.10.2024 PËR MIRATIMIN E DISA SHTESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË PIKËN 1, TË VKB-SË NR.575, DATË 20.12.2018, TË NDRYSHUAR, PËRSA I PËRKET VENDNDODHJEVE TË REJA TË VENDQENDRIMEVE TAKSI (4+1) DHE (8+1) NË QYTETIN E DURRËSIT
Pika 4.	PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VKB NR.06, DATË 10.02.2026 "PËR MIRATIMIN E VLERËS SË SHPRONËSIMIT TË PASURIVE PRIVATE QË PREKEN NGA PROJEKTI "LIDHJA E CURRILAVE ME RRUGËN A.GOGA"
Pika 5.	PËR MIRATIMIN PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 76, DATË 23.12.2025 TË KËSHILLIT BASHKIAK, "PËR MIRATIMIN PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 5, DATË 10.03.2025, "PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT PREJ 400703.84 (KATËRQIND MIJË E SHTATËQIND E TRE, PIKË TETËDHJETË E KATËR) LEKË, PËR PASURITË PRONË PRIVATE, SIPAS TABELËS SË HARTUAR NGA GRUPI I PUNËS, I NGARKUAR PËR KRYERJEN E VLERËSIMIT PARAPRAK, DHE ËSHTË PJESË E KËTIJ VENDIMI, QË PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK ME OBJEKT: "RIKONSTRUKSION RRUGE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ISHËM"
Pika 6.	PËR MIRATIMIN E DISA SHTESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË VENDIMET E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 20, DATË 11.06.2025, PËRSA I PËRKET Z.DANJEL MEHMETI DHE Z. PETRO DEDJA, NR. 21, DATË 11.06.2025, PËRSA I PËRKET Z.AGIM HODO DHE JUVENTUS KODRA SI DHE NR. 36, DATË 09.05.2022, PËRSA I PËRKET Z. SKËNDER ÇUKA
Pika 7.	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT, SI DHE NDRYSHIMIN E NR. RENDOR 12 TË TABELËS SË MIRATUAR ME VKB-NË NR.44, DATË 23.07.2025; TË NR. RENDOR 14 TË TABELËS SË PËRCAKTUAR NË PIKËN 9 TË VKB-SË NR.104, DATË 30.03.2023; TË NR. RENDOR 250 TË TABELËS SË MIRATUAR NË ANEKSIN 1 "SUBJEKTE PËRFITUESE TË GRANTIT TË RINDËRTIMIT NJËSIA

	ADMINSITRATIVE ISHËM” NË VKB-NË NR.72, DATË 20.07.2020; TË NR. RENDOR 27 TË TABELËS SË MIRATUAR NË ANEKSIN 1 “SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË ZONAVE TË REJA” ME VKB-NË NR. 86 DATË 29.07.2024
Pika 8.	PËR MIRATIMIN E SUBJEKTEVE APLIKUESE TË SHPALLURA PËRFITUESE, TË CILËT KËRKOJNË TË TRANSFEROHEN NË ZONAT E REJA PËR ZHVILLIM, SI DHE PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VKB-SË NR. 48, DATË 14.04.2021, TË VKB-SË NR. 67, DATË 10.06.2021, TË VKB-SË NR. 142, DATË 12.11.2021, TË VKB-SË NR. 83, DATË 27.09.2024, TË VKB-SË NR. 3, DATË 13.01.2023, TË VKB-SË NR. 141, DATË 24.11.2021, TË VKB-SË NR. 66, DATË 17.03.2023, TË VKB-SË NR.38, DATË 31.03.2021, TË VKB-SË NR. 117, DATË 30.09.2021, TË VKB-SË NR. 48, DATË 14.04.2021
Pika 9.	PËR MIRATIMIN E LISTAVE SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT NË PALLATIN KASTRATI NR. 14, RRUGA “STEFAN DHIMA”, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; PALLATIN NR. 8, RRUGA “STEFAN DHIMA”, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 3; PALLATIN NR. 25/1, RRUGA “HYSEN MYSHKETA”, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 3; PALLATIN NR. 18, RRUGA “DAVID SELENICA”, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; PALLATIN NR. 52, RRUGA “SELVIA”, NJËSIA ADMINISTRATIVE SUKTH; MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË NR. RENDOR 1 TË ANEKSIT NR. 1 “SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 2” TË VKB-SË NR. 79, DATË 29.07.2024, SI DHE MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË NR. RENDOR 1 TË ANEKSIT NR. 3 “SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 5” TË VKB-SË NR. 86, DATË 31.08.2020
Pika 10.	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.30, DATË 26.03.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROCESI I RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR.1032, RRUGA “ALEKS KOMNENI” DHE PALLATIN “KASTRATI”, RRUGA “RAMADAN VELIU”, TË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019” TË NDRYSHUAR
Pika 11.	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VKB-SË NR. 7, DATË 10.02.2026 “PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË FAMILJEVE QË PËRMBUSHIN KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E BONUSIT TË STREHIMIT, QË DO TË AKORDOHET NGA MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT NË FAVOR TË BASHKISË DURRËS PËR SUBVENCIONIMIN E QIRASË PËR VITIN 2026”
Pika 12.	PËR MIRATIMIN E NDIHMËS FINANCIARE ME VLERË TOTALE PREJ 10,242,173 (DHJETË MILIONË E DYQIND E DYZET E DY MIJË E NJËQIND E SHTATËDHJETË E TRE) LEKË, PËR LIKUIDIMIN E PLOTË TË FAMILJEVE TË DËMTUARA NGA PËRMBYTJET E SHKAKTUARA NGA RESHJET INTENSIVE TË SHIUT TË MUAJVE SHTATOR DHE NËNTOR 2025

Pika 13.	PËR EMËRTIMIN E GJIMNAZIT MANËZ, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE MANËZ, NË BASHKINË DURRËS
Pika 14.	PËR MIRATIMIN E NJË SHTESE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 34, DATË 12.06.2026 "PËR MIRATIMIN E HARTËS SË VENDQËNDRIMEVE TË MJETEVE LUNDRUESE DHE KORRIDOREVE TË LËVIZJES SË TYRE NË TERRITORIN E BASHKISË DURRËS"
Pika 15.	PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË VLERËSIMIT DHE TRAJTIMIT FINANCIAR PËR SPORTISTËT DHE TRAJNERËT QË PËRFAQËSOJNË QYTETIN E DURRËSIT NË KOMPETICIONE KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE PËR VITIN 2026
Pika 16.	PËR MIRATIMIN E PROJEKTDOKUMENTIT TË PARË TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2027-2029 TË BASHKISË DURRËS
Pika 17.	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË VLERËS FINANCIARE PREJ 109,276,634 (NJËQIND E NËNTË MILION E DYQIND E SHTATËDHJETË E GJASHTË MIJË E GJASHTËQIND E TRIDHJETË E KATËR) LEKË, PËR LIKUIDIMIN E PLOTË TË FAMILJEVE TË PATRAJTUARA DHE PËR PËRFUNDIMIN E LIKUIDIMIT TË FAMILJEVE TË TRAJTUARA PJESËRISHT FINANCIARISHT, NË ZBATIM TË VKB-SË NR. 75, DATË 23.12.2025 TË DËMTUARA NGA PËRMBYTJET E SHKAKTUARA NGA RESHJET INTENSIVE TË SHIUT TË DATAVE 29.01.2025 – 30.01.2025
Pika 18.	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 694,220 (GJASHTËQIND E NËNTËDHJETË E KATËR MIJË E DYQIND E NJËZET) LEKË TË RIMBURSUARA NGA PROJEKTI TERRAIN, PROGRAMI INTERREG IPA ADRION (2021-2027)
Dhe pika fundit Pika 19.	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT TË PALLATIT NR. 32 RRUGA "TEODOR RUPI", NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.3, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, SI DHE MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË NR. RENDOR 11, ANEKSI 1 I VKB-SË NR.3, DATË 13.01.2023 "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË 13 TË 11 SUBJEKTEVE PËRFITUESE, TË CILËT DO TË PËRFITOJNË MASËN E GRANTIT TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019, SIPAS PROJEKTIT MODEL"

Keni ndonjë koment ? Jeni dakord me rendin e ditës.
Po Muka.

Ardian Muka: Mirëdita zonja kryetare, zonja nënkryetare, të nderuar kolegë.
Do tërhiqja vëmendjen sepse është e disata herë që ne kthehemi dhe rikthehemi në këtë në këtë argument. Meqëse nga ana e bashkisë sot e kësaj dite vazhdojnë edhe na sillen materiale, që vijnë këshillin bashkiak pastaj për t'u trajtuar në mbledhjen plenare të të këshillit jashtë afatit ligjor që është pesëditshi. Natyrishtkuptojmë ngarkesën që mund të ketë edhe ana e bashkisë dhe i mirëkuptojmë në detyrën e tyre, por nga ana tjetër nuk na kushton asgjë që materiale, të cilat nuk arrijnë të kapin afatin e duhur të spostohen për mbledhjen tjetër. Kësaj radhe kishte shumë materiale të cilat ishin sensitive, ishin materiale në...

Denisa Luarasi: Patjetër e diskutuam në kryesi.

Ardian Muka: Materiale në dobi të komunitetit dhe patët atë pjesën e bashkëpunimit dhe të mirëkuptimit tonë, por nga ana tjetër nuk mund të vazhdojmë kështu. Unë do propozoja që të bëjmë një ndryshim në rregulloren e Këshillit Bashkiak.

Denisa Luarasi: Të bëjmë dy mbledhjen në muaj.

Ardian Muka Jo, mbledhjen nuk mund ta ndryshojmë, sepse ajo është ligjore, por do kërkoja që mbledhja e kryesisë kryetarëve të grupeve të jetë një mbledhje ku të merret vendim.

Denisa Luarasi: Ëhë...

Ardian Muka : Pra mos të jetë thjesht një organ këshillues edhe informues. Pra ne na vijnë si informacion dhe e përcjellim japim ok. Kjo mbledhje të jetë një mbledhje vendimmarrëse. Në qoftë se do themi që këto mbledhje nuk do futen këto materiale, sepse janë jashtë afatit ligjor ne të respektojmë këtë.

Denisa Luarasi: Je shumë i qartë, do ndryshohet rregullorja. Ashtu do mbledhim komisionin, patjetër.

Ardian Muka: Këtu kërkoj mirëkuptimin e të gjithë kolegëve, gjithashtu dhe të stafit të bashkisë.

Denisa Luarasi: Patjetër ju falenderoj për sugjerimin dhe mbështetjen tuaj në kalimin e këtyre pikave.
Po ja se po falenderoja Mukën, Flutura.
Të lutem Flutura se nuk ta kamë dhënë fjalën.

Flutura Kasa: Po do ma japësh.

Denisa Luarasi: Patjetër.

Flutura Kasa: Okej.
Meqënëse me zotin Muka jemi bërë kështu si duet, që sa herë flet duhet t'i kthejmë përgjigje, kisha vetëm diçka. Çfarë janë çështje për rindërtim, ndihmë ekonomike, përmbytje, që kanë lidhje

direkt me komunitetin. Me vërtetë është për t'i tërhequr vëmendje administratës, që t'i marrin punët më përpara, por çfarë janë çështje që kanë lidhje direkt me komunitetin, unë do votoj pra edhe sikur të vijnë në minutë të fundit. Vetëm se dua diçka. Na i paraqitni ça janë çështjet e rindërtimit personat edhe me një dosje, ka mundësi t'i shohim edhe vetë ato dokumentat që janë nëpër dosje? Që mos kemi pastaj probleme më mbrapa. Kaq kisha.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Flutura Kasa: Kështu që çfarë janë çështje për komunitetin.....

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Flutura Kasa: ....deri në sekondë të fundit do i votoj edhe për kaq kohë sa më ka ngel që jam këshilltar.

Denisa Luarasi : Faleminderit zonja Kola.
Kalojmë në votim elektronik.
Me 30, me 35 vota pro dhe 1 abstenim miratohet rendi i ditës pa ndryshime.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 1,** Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Përshëndetje të gjithëve.
Komisioni ynë e miratoi pikën e parë dhe ftojmë këshillin që t'i japi votën pro. Faleminderit.

Denisa Luarasi : Faleminderit zonja Musaraj.
Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqenies Sociale dhe Mosdiskriminim zonjës Edlira Shemsi.
Ju lutem thërrit mikrofonin.
Jo, nuk e ke thërritur mikrofonin. Shtype.

Edlira Shemsi: Atëherë Komisioni i Çështjeve Sociale, Barazisë Gjinore dhe Kundër Diskriminimit me shumicë korumi miratoi listën për ndihmën ekonomike brenda fondit limit 6% dhe me të ardhurat e bashkisë për muajin qershor 2026 dhe ja paraqet këshillit për votim.

Denisa Luarasi : Faleminderit zonja Harizi.
Pyetje, komente kemi për pyetjen për pikën 1, të rendit të ditës?
Kalojmë në votim.
Me 36 vota pro miratohet pa ndryshime pika 1 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 2**, Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Edhe pikën e dytë ne e votuam dhe ftojmë këshillin që të japi votën pro. Faleminderit.

Denisa Luarasi : Faleminderit.
E merr fjalën Komisioni Barazisë Gjinore, Mirëqenies Sociale dhe Mosdiskriminimit, zonja Edlira Harizi.

Edlira Shemsi: Komisioni i Çështjes Sociale, Barazisë Gjinore dhe Kundërdiskriminimit në lidhje me pikën në fjalë, duhet t'i bëjë disa pyetje përfaqësues së bashkisë në lidhje me relacionin që do lexojë.

Denisa Luarasi: Jo, jeni dakort?
Pastaj te komentet, pastaj kemi pjesën e komenteve.
Jeni dakord që të kaloj?

Edlira Shemsi: Ajo mund t'i kalojë këshillit, por gjithsesi ne duam të bëjmë pyetjet tona për diskutim.

Denisa Luarasi : Si keni votuar në komision.

Edlira Shemsi: Shumica ka votuar që të kalojë në komision....

Denisa Luarasi : Faleminderit.

Edlira Shemsi: .....por me pyetje përkatëse që i kam shkruar edhe në relacionin e mbledhjes që u bë.

Denisa Luarasi Me radhë t'i marrim me radhë. Pra keni rënë dakord që të kalojë?

Edlira Shemsi: Po, por kam shkruar në relacionin e mbledhjes që këtë pikë unë do kërkoj informacion.

Denisa Luarasi: Atëhere ka komente dhe pyetje për pikën 2 të rendit të ditës?

Joniada Musaraj: Pikën dy e ka komisioni kryetare?

Denisa Luarasi: Komisioni e kaloj.
Edlira, ke pyetje?

Edlira Shemsi Po, po kam.

Denisa Luarasi: Vazhdo me pyetjet.

Edlira Shemsi : Në lidhje me përfaqësuesen e bashkisë për relacionin që është dhënë. Është bërë dhe një dëgjesë. Në fakt unë siç kam komunikuar dhe me ju zonja kryetare për arsye objektive se kam qenë në një konferencë jashtë vendit, nuk kam qenë dhe nuk arritëm dot të lidheshim online, por rezervova të drejtën do bëj pyetjet çka e thashë edhe në komision dje.

Denisa Luarasi: Po mund ti paraqisësh pyetjet.

Edlira Shemsi : Po pyetja e parë në lidhje me zbatimin vendor të planit për barazinë gjinore 2026-2030 : A janë mirëmenduar dhe janë evidentuar të gjitha burimet financiare? Sepse në relacion, unë e lexova relacionin, thuhej se akoma procesi i kostimit të këtij plani nuk ka përfunduar. Atëhere sa është kosto dhe ku janë burimet që janë menduar që ky plan të realizohet? Pyetja e parë.
Pyetja e dytë: Sa fonde janë parashikuar për fuqizimin ekonomik të grave dhe vajzave, të cilat kanë kërkuar ndihmë dhe përkrahje ekonomike pranë bashkisë Durrës? Dhe sa punonjës është parashikuar që do jenë në dispozicion të kryerjes së dhe zbatimit të këtij plani 2026-2030 për barazinë gjinore në lidhje me ndihmën, që do jepet edhe suporti që do jepet për gjithë gratë dhe vajzat që do kërkojnë ndihmë? Janë këto punonjës, janë aktualisht apo në kostimet që do bëhen janë parashikuar dhe rritja e strukturës së punonjës të tjerë.
Pyetja tjetër: Çfarë nënkupton termi "transformim i roleve tradicionale gjinore", i cili është përshkruar në relacion? Ku është bazuar ky? Në ligjin e kaluar në parlament tashmë së fundmi për barazinë gjinore, ligj i cili u kundërshtua jo vetëm nga opozita, por nga të gjithë përfaqësuesit institucioneve fetare dhe organizata të tjera. Ku është bazuar ky term dhe çfarë kupton? Termi "transformim i roleve tradicionale gjinore"? Domethënë, ndoshta unë jam gabim, por një burrë, i cili e ndjen veten grua të kërkojë ndihmë si grua e dhunuar. Çfarë nënkupton ky term?

Denisa Luarasi Faleminderit.
Zonja, po.

Diola Xhango (drejtoresha): Përshëndetje të gjithëve.
Diola Xhango, Drejtoresha e Shërbimit Social në Bashkinë e Durrësit. Në lidhje me pyetjet po e filloj nga pyetja e fundit meqënë se përkostimin flet drejtoresha e buxhetit. Patëm një diskutim pak para mbledhjes në lidhje me termat, që janë përdorur në planin e barazisë gjinore.
Si fillim plani i barazisë gjinore për bashkinë e Durrësit 2026-2030 është totalisht i bazuar në konventat europiane, ligjet europiane, strategjinë kombëtare për barazië gjinore 2021-2030 dhe patjetër te ligji i fundit për barazinë gjinore, i cili është miratuar në parlament.
Në lidhje me qasjen transformuese që ju flisni si term, që e keni lexuar në fakt në planin e barazisë gjinore, qasje "transformuese gjinore" nuk ka të bëjë me transformimin gjinor të njeriut. Pra, nuk ka ndërmend ky plan ta kthejë burrin në grua dhe gruan në burrë. Transformimi gjinor ka të bëjë me gratë e dhunuara, me gratë vulnerabël, të cilat kërkojnë të transformojnë gjendjen e tyre si ekonomike dhe madje po ta lexoni ka katër pika kryesore ky plan, që është fuqizimi ekonomik, ja ku i keni, rritja e pjesëmarrjes në vendimmarrje, parandalimi dhe adresimi i dhunës për gratë dhe vajzat, si dhe dhuna në familje, si dhe konsolidimi i mekanizmave institucional. Le të themi të bëhet pak më konkrete, këto mbledhjet që bëjmë për dhunën, siç kemi mekanizmin e koordinuar që jo para pak ditësh e kemi mbledhur në lidhje me problematikat për gratë e dhunuara me urdhër mbrojtje. Kështu që nuk ka të bëjë me transformimin gjinor siç e thashë burrë grua, grua burrë, po ka të bëjë me transformimin e një gruaje vulnerabël. Ky është thelbi.
Ky plan i barazisë gjinore nuk mund të diskriminojë grupe të veçanta. Prandaj dhe LGBT është e përfshirë, siç janë të përfshira disa grupe dhe i keni shumë mirë të cituara në relacion. Dhe ju keni

një shprehje gjatë gjithë kohës te plani i barazisë gjinore ku thuhet : “nga të gjitha grupet” dhe kjo është një shprehje, të cilën neve nuk mund ta përjashtojmë LGBT-n është detyrim ligjor, që ne do përfshijmë të gjithë. Por plani i barazisë gjinore synimin kryesor e ka për gratë dhe vajzat, burrat dhe djemtë, të rinj dhe të rejat. Dhe sidomos siç e kemi cituar për gratë, të cilat janë vulnerabël, janë gra të dhunuara, janë nëna të divorcuara, që kanë nevojë për mbështetje, fuqizim ekonomik dhe mbështetje institucionale.

Denisa Luarasi Shumë faleminderit.

Diola Xhango Në rastin, jo më fal, në rastin e grupeve LGPT-ë, ka një plan kombëtar dhe bashkia e Durrësit duhet të bëjë një plan të veçantë për këtë grup. Pra ky plan i barazisë gjinore nuk është i dedikuar për LGBT-në, por ne nuk mund ta mos ta përfshijmë dhe ta rendisim te grupet e përfshira. Kjo është.
Në lidhje me stafin. Bashkia e Durrësit ka të dedikuar një punonjës për barazinë gjinore në Drejtorinë e Shërbimit Social e cila merret e ka dedikuar pozicionin e saj dhe gjatë gjithë kohës për këtë plan, patjetër që do mbajë evidencat e saj. Por kjo s'do të thotë që ky plan është deri në 2030-n dhe nuk do mund të ndryshojë me vitin.
Pastaj për punën e kostimit do më falni, po është Drejtoria e Buxhetit.

....flasin nga salla pa mikrofon....

Diola Xhango : Po do do shikohet vit mbas viti në bazë të .....
Po, Edlira më thuaj.

Denisa Luarasi: Faleminderit drejtoresha.

Edlira Shemsi: Okej, sigurisht unë e kuptoj që nuk bëhet fjalë që bashkia të nisi një projekt për kthimin e burrave në gra, ashtu siç thatë, sepse këtë e ka marrë përsipër ligji për trajtimin hormonal dhe nuk ka ngelur ta bëjë bashkia, se duhet e bëjnë me fondet e dhënë për ligjin për trajtimin hormonal, por atëhere përgjigja është shumë e saktë. Ndërkohë që këtu flitet për planin, për mbështetjen e grave, për barazinë gjinore për gratë, specifikisht për gratë e dhunuara në vështirësi ekonomike, me probleme sociale. Ndërkohë u tha qartë tashmë.....

Denisa Luarasi: Doktoresha, a u sqarove?

Edlira Shemsi Jo kam të drejtën, kam të drejtën, kam të drejtën, ju lutem zonja kryetare kam të drejtën të komentoj. U bë e qartë që këtu bëhet fjalë dhe për komunitetin LGPT, që në fakt nuk ishte në këtë plan, por na qenë ka futur tashmë që një pjesë të buxhetit do ta marri komuniteti LGBT. Më fal.

Denisa Luarasi: Jo jo mos ndryshoni.

Edlira Shemsi : Jo fare nuk e ndryshoj.

Diola Xhango Jo, të lutem mos ndrysho qasjen që unë fola.
Absolutisht jo.

Edlira Shemsi: Dhe edhe një gjë tjetër, më fal zonja drejtoreshë. Edhe një pyetje tjetër që mund t'ua kisha bërë dhe më parë. A e keni numrin e grave dhe vajzave të dhunuara, që janë trajtuar nga bashkia deri në këtë periudhë për çfarë ka qenë në planin e mëparshëm? Dhe sa është numri i grave dhe vajzave, të cilat janë ndihmuar në sipërmarrjet e tyre apo në aktivitetet e tyre?

Diola Xhango : Për informacion të mëtejshëm me detaje mund ta jap me shkrim. Po, po të them që për 2025-ën janë trajtuar 339 raste të grave me urdhër mbrojtje nga bashkia e Durrësit dhe aktualisht nga janari deri më sot që flasim janë 215 raste të suportuara nga Drejtoria e Shërbimit Social patjetër në bashkëpunim me Drejtorinë Vendore të Policisë së Shtetit dhe me institucionet e tjera, të cilat kemi bashkëpunim.
Të gjitha këto gra mbështeten pranë qendrave tona sociale me shërbim psikologjik, juridik falas after school për fëmijët e vet dhe suportim për t'i mbështetur, për të gjetur punë dhe për t'u fuqizuar ekonomikisht.

Edlira Shemsi: Dhe për banesë apo jo?

Diola Xhango: Dhe për banesë patjetër.

Edlira Shemsi: Sa nga këto janë suportuar për banesë?

Denisa Luarasi : Edlira , të lutem.
Drejtoresha...

Edlira Shemsi: Po unë do pyes, ndërkohë që flet zonja.

Diola Xhango: Jo, jo ta them se i kam shifrat.

Denisa Luarasi: Eshte prezantuar shumë mirë në takimin kur është prezantuar plani.

Diola Xhango: Unë sapo e kam marrë strehimin social.

Denisa Luarasi: Mos ta kthejmë në pazar.

Edlira Shemsi: Ju lutem zonja kryetare po na le të marrim përgjigje tashi. Mos bëni zhurmuesin, ju lutem. Sa kanë marrë nga këto ndihmë për Strehim?

Diola Xhango: Nga Drejtoria e Shërbimit Social në shkurt të referuara gra me urdhër mbrojtje, le të themi, gjashtë muaj deri në një vit janë referuar 8 gra, të cilat janë aktualisht në listën e bonusit të qerasë me 50%.

Edlira Shemsi: Gjashtë gra.

Diola Xhango: Tetë dhe ju aktualisht...

Edlira Shemsi: Nga 300 që kanë kërkuar ndihmë kanë marrë 8.

Diola Xhango: ...e keni miratuar dhe vendimin prej 5 milion lekësh për gratë e dhunuara me urdhër mbrojtje të menjëhershëm, që mbas Qendrës së Emergjencës 72 orë, kalojnë nga Drejtoria e Shërbimit Social në Drejtorinë Ekonomike me veprime të përshpejtuara për të kaluar direkt me bonusin e qeras

Edlira Shemsi : Po ju kuptoj, ju faleminderit po nga 300 që kanë kërkuar ndihmë sa nga këta vazhdojnë te jetojne me dhunuesin, sepse nuk kane marrë akoma suport?

Diola Xhango : Jo të gjitha gratë që kanë urdhër mbrojtje, të lutem se duhet të bazohemi dhe te ligji i strehimit.

Edlira Shemsi : Jo të gjitha, se e kemi diskutuar bashkë në komision, por një pjesë e konsiderueshme kanë kërkuar suport për strehim dhe nga halli se nuk e kanë marrë, vazhdojnë të jetojnë në një shtëpi me dhunuesin.

Denisa Luarasi : Edlira do **v**azhdosh me pyetjen.
Faleminderit. Faleminderit drejtoresha.

Edlira Devolli : E kam kërkuar.

Denisa Luarasi : Edlira, vazhdo.

Edlira Devolli: Si të vendosi drejtuesja.
Si të vendosi drejtuesja.

Diola Xhango : Edlira më thuaj rastin konkret dhe pastaj e flasim, sepse mund të ketë gra që e kanë marr bonusunin e qerasë dhe kane zgjedhur të jetojnë afër bashkëshortit. Është një zgjedhje e tyre.

Denisa Luarasi: Jo, Edlira do flasë.
Meqë kemi barazinë gjinore të respektojmë gratë.
Edlira, Edlira bëj pyetjen.

Edlira Devolli : Mos të diskriminojmë burrat gjithsesi.
Faleminderit zonja drejtuese e seancës.

Denisa Luarasi Të lutem pak qetësi ta dëgjojmë Edlirën.

Edlira Devolli: Faleminderit.

I nderuar zëvënëskryetar, të nderuar përfaqësues të administratës, të nderuar këshilltarë!
Kam përgatitur një diskutim për pikën 2. Nuk besoj se zgjat më tepër se 2-3 minuta në lidhje me relacionin për miratimin e planit vendor të veprimit për barazi gjinore 2026-2030 në bashkinë Durrës, dua të shpreh disa rezerva parimore dhe përmbajtësore, të cilat e konsideroj të rëndësishme për t'u marrë në konsideratë përpara miratimit të këtij dokumenti.
Së pari, dua ta bëj të qartë që në fillim, qëndrimi im nuk ka të bëjë me nxitje, urrejtje, përjashtim apo mohim të drejtave të askujt. Çdo qytetar i Durrësit, pavarësisht bindjeve, mënyrës jetesës, orientimit apo vetëperceptimit personal duhet të trajtohet me dinjitet, të mbrohet nga dhuna, të mbrohet nga diskriminimi dhe çdo formë abuzive.

Denisa Luarasi Të lutem, kalojmë tek pyetja Edlira, të lutem.

Edlira Devolli: Jo të lutem. E kam diskutim, e kam diskutim. Nuk po...

Denisa Luarasi : Ok, ok. Vazhdo mirë. Vazhdo diskutimin.

Edlira Devolli : Jo, jo. Kjo është detyrë e institucioneve publike në parim bazë i një shoqërie demokratike.

Flutura Kasa : Po ça diskutime...

Edlira Devolli: Jo, megjithatë e kam opinionin tim.

....*flasin gjithë përnjëherë diskutim në sallë...*

Edlira Devolli: Megjithatë pikërisht është për pikën 2.

Denisa Luarasi: Muka mos u nxeh. Ja kam lënë fjalën.

Edlira Devolli: Megjithatë pikërisht për shkak se flasim për një dokument publik që do të orientojë politikat vendore për disa vite, mendoj se duhet të jemi shumë të kujdesshëm në mënyrën se si ndërtohen kategoritë, prioritetet dhe ndërhyrjet konkrete. Në materialin e paraqitur në disa pjesë, trajtimi i grave dhe vajzave të dhunuara, grave në nevojë, nënave të vetme, personave të trafikuara, personave me aftësi të kufizuar dhe kategorive të tjera të cënueshme vendosen në të njëjtën kornize me çështjen që lidhet me orientimin seksual apo shprehjen e identitetit gjinor.
Unë nuk jam dakort që këto çështje të bashkohen në mënyrë të përgjithshme pa ndarje të qartë, sepse nevojat, problematikat dhe ndërhyrjet institucionale nuk janë të njëjta. Një grua e dhunuar në familje, një vajzë e trafikuar, një nënë e vetme në pamundësi ekonomike apo një e moshuar pa mbështetje sociale, ka nevoja urgjente për strehim, mbrojtje, ndihmë ekonomike, shërbime sociale, mbështetje psikologjike dhe siguri fizike. Këto janë situata konkrete cënueshmërie dhe dhune, të cilat kërkojnë masa të drejtpërdrejta dhe të matshme nga bashkia.
Nga ana tjetër, çështjet që lidhen me orientimin seksual apo identitetin gjinor nuk duhet të trajtohen në mënyrë të tillë që të zbehin fokusin kryesor të këtij plani. Mbrojtjen dhe fuqizimin e grave, vajzave dhe familjeve të prekura nga dhuna, varfëria dhe përjashtimi social. Askush nuk

duhet të mbetet pa mbrojtje. Por dokumenti nuk duhet të bëjë dallim të qartë ndërmjet kategorive që përjetojnë dhunë konkrete dhe çështje që lidhen me vetë identifikimin apo mënyrën personale të jetesës.
Po ashtu kam rezerva ndaj formulimit që flet për një "qasje transformuese gjinore", e cila synon transformimin e normave shoqërore dhe roleve tradicionale gjinore. Unë besoj se bashkia duhet të mbrojë barazinë para ligjit, dinjitetin njerëzor dhe aksesin në shërbime, por nuk duhet marrë përsipër të transformojë familjen tradicionale apo të ndërhyjë në mënyrën se si qytetarët e ndërtojnë jetën e tyre familjare dhe shoqërore. Familja tradicionale për shumë qytetarë të Durrësit mbetet një vlerë themelore e shoqërisë. Theksoj se të jesh pro familjes tradicionale nuk do të thotë të jesh kundër dikujt tjetër.

Denisa Luarasi : Edlira, mund të bëjë një ndërhyrje..

Edlira Devolli Nuk do të thotë të mohosh të drejtat e individëve. Do të thotë të kërkosh institucionet publike të mos e paraqisin familjen tradicionale si pengesë.....

Denisa Luarasi: Edlira po te kishe qenë në dëgjesë të gjitha këto pyetje tuaja do ishin marrë parasysh. Ju nuk erdhët në dëgjesë.

Edlira Devolli: ....që duhet transformuar, po si një strukturë që duhet mbështetur, forcuar dhe mbrojtur sidomos kur flasim për mirëqen sociale, mbrojtje të fëmijëve, parandalim të dhunës dhe stabilitet komunitar.

Denisa Luarasi : Po tani pse s'erdhe në dëgjesë.

Edlira Devolli: Zonja drejtuese, unë po shfrytëzoj minutat e mia për të folur dhe nuk më duket aspak e hijshme që të mos më dëgjosh deri në fund.

Denisa Luarasi: Bëmë dëghjesën, kishim komunitetin.

Edlira Devolli: ...dhe që t' jepte përgjigje dhe zonja Xhango diskutimit tim. Thashë do t'i bëja dhe unë pyetjet.

Hekuran Markola: Kërkoj fjalën...ta marrë fjalën?

Denisa Luarasi: Tani tani flisni kot.

Edlira Devolli: Në Komisionin e Rregullores dhe Çështjeve Juridike e kam votuar kundër, duke propozuar që dokumenti të rishikohet në disa pika.
Së pari të ndahet më qartë trajtimi i dhunës ndaj grave, dhunës në familje, trafikimit, varfërisë, aftësisë së kufizuar dhe nevojave sociale nga trajtimi i çështjeve, që lidhen me orientimin seksual apo identitetin gjinor.
Së dyti, të shmangen formulime që mund të interpretohen si përpjekje institucionale për të transformuar familjen tradicionale, rolet familjare apo normat shoqërore të qytetarëve.

Tre, të ruhet fokusi kryesor i planit tek gratë dhe vajzat, sidomos ato që janë viktima dhunës në nevojë ekonomike, në zonat rurale, në familje të vështira, në situata emergjence apo në rrezik social.
Së katërti, të garantohet që çdo person që pëson dhunë apo diskriminim të marrë mbrojtje dhe shërbim, por pa e zhvendosur thelbin e këtij plani nga barazia gjinore dhe mbrojtja e grave dhe vajzave drejt një axhende më të gjerë ideologjike.
Unë jam për një plan që mbron gratë, vajzat, nënat, familjet dhe çdo qytetar në nevojë. Jamë për shërbime sociale reale, për më shumë mbështetje ekonomike, për strehim të menjëhershëm për viktimat e dhunës, për mekanizma më të fortë institucional dhe për transparencë në zbatim të planit. Por nuk jam dakort që në emrin e barazisë gjinore të futen formulimet, që mund të cënojë konceptin tradicional të familjes ose të vendosin në një plan situata krejt të ndryshme sociale dhe ligjore.

Denisa Luarasi : Faleminderit.

Edlira Devolli Të nderuar kolegë, kërkoj që ky dokument të mos miratohet në këtë formë, por të rishikohet me kujdes në mënyrë që të jetë gjithëpërfshirës, por edhe i qartë, i balancuar, i ndjeshëm ndaj realitetit të komunitetit tonë dhe në përputhje me vlerat shoqërore dhe qytetare të Durrësit. Faleminderit.

Hekuran Markola: Mund të vazhdoj pak?

Denisa Luarasi : Faleminderit.
Po Markola . Po mund.

Hekuran Markola: Faleminderit.
Jo, një sekond, një sekondë. Më fal, më fal, kur të jepet fjala.
Jo, jo, e kam marrë fjalën unë.

Flutura Kasa Më fal kena qenë në dëgjesë. Me na dal këtu para ekranit, që po bëjmë ...
Po i flas asaj se e kam edhe mikesh, me ardhë para ekranit me bë spektakël nuk jemi keq se vij 65 vjeç grua në të gjitha dëgjesat, bujrum le të vijë.

Hekuran Markola : A të filloj pak.

Flutura Kasa: Ose të vinte kjo zonja, se ka ardhur pyetja para pesë ditëve. Jo se nuk bëhet kështu.

Denisa Luarasi : Flutura ke të drejtë shumë, ja thashë, por ja kam dhënë fjalën Markolës.

Hekuran Markola: Edlira, dëgjo pak.

Denisa Luarasi: Ja kam dhënë fjalën Markolës.
Po Markola.

Hekuran Markola: Dëgjo fjalën e kam unë. Edlira, 1 sekond.

Denisa Luarasi: Flutura, ke shumë të drejtë, ke shumë të drejtë.
Markola mund të flasësh? Markola ta kam dhënë fjlalën. Vazhdo fol se ti inçizohesh.

Hekuran Markola: Tani, unë kam qenë tek dëgjesa publike.

Denisa Luarasi: Edlira ta dëgjojmë kolegun , se ju dëgjuam.

Hekuran Markola: Edlira me ty e kam.
Unë kam qenë tek dëgjesa publike. Në fakt isha në fund i vetmi mashkull aty.
Duhet të kuptojmë një gjë. Si fillim nuk ka të bëjë fare me grupet dhe me çfarë diskutohet këtu. Fare fare fare. Këtu ka të bëjë për barazinë gjinore që barazia gjinore nuk është vetëm për, siç referohen për gratë.

Denisa Luarasi: Mbajmë pak qetësi, respektojmë këshilltarin.

Hekuran Markola : Barazia gjinore është për termin grua dhe termin burrë dhe barazia gjinore është e dyanshme si për gratë dhe si për burrat.

....*flitet pa mikrofon .....*

Rolant Xhelilaj: Edlira ka për ty, po s'ka për ne.

....*Flasin njëkohësisht Edlira dhe Rolant pa mikrofon ....*

Hekuran Markola Nuk ka të bëjë fare.
Ky plan 2026-2030 nuk ka të bëjë fare, po fare fare , me grupimet që përflitet këtu LGBT ku ta di unë. Këtu ka të bëjë me barazinë gjinore, që janë dy e dyanshme jo vetëm për gratë e dhunuara, por edhe për burrat në raste kur i takon. Dhe bëhet fjalë për termin grua dhe termin burrë. Kush e ndjenë vetë grua quhet grua. Kush e ndjenë veten burrë quhet burrë. Tani mendësia “transformimit gjinor” është transformimi i mendësisë së gruas për t'u integruar dhe për t'u bërë qytetare si gjithë të tjerat dhe të denoncojë dhe mos pranojë dhunën. Ky është ai termi aty.
Kaq kisha. Mirupafshim.

Denisa Luarasi : Faleminderit. Zoti Markola

Joniada Musaraj: Jo. Të lutem replikën jo. Jo, jo Edlira replikën jo. Absolutisht nuk ta përmendi emrin.

.....*flasin njëkohësisht pa mikrofon ....*

Denisa Luarasi : Të lutem Edlira, të lutem.

Joniada Musaraj: E kam unë fjalën.
E kam unë fjalën. Zonja Devolli emrin, mbiemrin s'ta përmendi. Nuk ke të drejtë replike.
Zoti Muka na u hodh nga kati i katërt në katë të parë ...

Denisa Luarasi: Të lutem, të mbarojë zonja Musaraj. Patjetër ta jap fjalën, të mbaroj zonja Musaraj. Dëgjoni njëri-tjetrin, respektoni njëri-tjetrin.
Ja kam dhënë fjalën zonjës Musaraj, të mbaroj zonja Musaraj pastaj do ta jap fjalën me qetësi. Ruani qetësinë.

Joniada Musaraj : Zonja kryetare, unë i mirëkuptoj këshilltarët se kur bëjnë gafa të mëdha deputetët e opozitës dhe diskutonin atëherë për ligjin dhe thonin se do t'i bëjnë burrin grua dhe gruan burrë. Unë e mirëkuptoj këshilltar se kur bëjnë gafa të mëdhenjtë ata që i kemi zgjedhur atje. Jo, jo, jo.

....*flitet pa mikrofon* .....

Joniada Musaraj: Atëhere ja çfarë thotë plani ja çfarë thotë plani. Thotë që të hiqet.....
Po më lër të flas. Po më lër të flas tani. Po më lër të flas.
Po do ta them atë që kam ndërmend do ta them

Denisa Luarasi: Edlira të , se je pa mikrofon.

....*flasin njëkohësisht nga salla*....

Joniada Musaraj: Atëhere.....
Po marr përsipër, po marr përsipër të të sqaroj, që e keni keqkuptuar. Është ajo që thotë dhe zoti Markola duhet hequr kur themi "transformim mendësie" që do të thotë barazi gjinore duhet të trajtohet dhe burri dhe gruaja njësoj dhe të integrohen në shoqëri dhe të ndihmohen njësoj një burrë dhe një grua. Ky është transformimi. Flet për transformim mendësie tradicionale që deri dje ne thonim që burri është i forti dhe gruaja është vulnerabël.

....*flitet pa mikrofon* .....

Joniada Musaraj: Po unë e kuptoj si këshilltare, se nuk e ke kuptuar ti, nuk do të thotë që është ashtu si thua ti. Më thoni pak, më thoni.... Edhe njëherë, më thuaj pak me cilën bazë ligjore një këshill bashkiak mund të vë në diskutim këtë që thoni ju. Më thuaj, më thuaj ç'kompetencë.

....*flitet pa mikrofon njëkohësisht* .....

Joniada Musaraj: Doni të kapeni ju tani te togfjalëshët?
Po kapeni te togfjalëshët kot tani, nuk është qëllimi fare ai.
Kryetare kaloje këtë pikë.

....*flitet pa mikrofon njëkohësisht* .....

Denisa Luarasi : Do flasësh ?

Edlira Devolli : Zonja Kryetare, të lutem, e kam..... Jo një sekondë.
E kam shumë të rëndësishme se që në fillim të diskutimit thashë që, nuk jam kundër trajtimit të grupeve LGBT plus që administrata dhe këtë e kishte shkruar gabim. Thjesht saktësoni termat, bëni ndarjen e koncepteve dhe silleni per votim .

Joniada Musaraj: Moj nuk ka nevojë ta bëjë drejtoresha me bashkinë. Moj e kam të qartë.

Denisa Luarasi : Ka kërkuar fjalën kryetari i grupit socialistë Rolanti.

....flitet pa mikrofon njëkohësisht .....

Rolant Xhelilaj: Edira të na japësh mundësinë të themi ndonjë llafë

....flitet pa mikrofon njëkohësisht .....

Denisa Luarasi E ke në email, e ke të pasqyruar, e ke online.

....flitet pa mikrofon njëkohësisht .....

Rolant Xhelilaj: Edlira..... Edlira, Edlira dëgjo një çik, dëgjo....
E di, e di si është puna? Kryetare do të bëjë një vërejtje Mbas mbarimit të diskutimit të pikës për votim ose jo dhe komentit që ka diskutimi atë jepet e drejta të flasi tre minuta jo leksion, sepse me gjithë respektin shumë të madh që kam për zonjën Devolli ishte leksion. Një leksion që vjen nga një situatë e kopjuar diku tjetër, është e drejta asaj brenda tre minutave të thotë çfarë të dojë, por nuk ka të drejtë të kundërshtojë ose të vërë në pozitë të vështirë institucionin, i cili thotë jemi bazuar në të gjitha konventat, ligjet, nënligjet, aktet e dala për këtë proçes, për këtë punë.
Edlira Shemsi e kupton ndryshe. Le ta kuptojë ndryshe, ta mbaj për veten e vet dhe nuk ka nevojë dhe mos prano replikë. Nuk ka replikë, nuk ka replikë këtu për këtë. Gjithkush jep opinionin e tij. Replika është votë. Sa herë dikush thotë një opinion, ti e ke paraqitur projektligjin, që do japësh opinion për të gjithë Edlira. Ajo thotë opinionin e vet. Ti the tëndin ç'është replika në këtë rast? Për çfarë hyn? Nuk më pëlqen kjo formë për gjëra që ne i dimë dhe për minimumin e respektit që kemi për njëri-tjetrin. Dëgjoje drejtoreshën. Nuk je dakort. Voto kundër. Opinionin tënd e the. Ai opinion s'ka lidhje fare me mënyrën si e trajtoi drejtoresha. Këtu jemi në dy pozicione të dyshimta me njëri-tjetrin. Ju s'besoni. Ne besojmë të institucioni. Kaq është diferenca. Komentet e tjera janë pa vlerë.

Joniada Musaraj: Por nuk merr përsipër....

Edlira Devolli: Absolutisht me gjithë....

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Xhelilaj.

Jo do flasi drejtoresha, ke diçka për të sqaruar?

Denisa Luarasi Të lutem, Edlira s'ka replikë do flasi drejtoresha. Po, të lutem.
Po, drejtoresha, ta dëgjojmë drejtoreshen.

Diola Xhango: Kur mora fjalën, ju sqarova pak a shumë në vija të shkurtra të gjithë planin. Mbasi e mbylla fjalën, ju zonja Devolli kishit një letër përpara që e kishit përgatitur dhe e kishit ndarë mendjen për ta lexuar atë letrën. Ndërkohë që gjithçka që lexuat aty unë e kisha sqaruar. E para.
E dyta në lidhje me gjithë problematikat që ju cituat për gjithë grup grupet vulnerabël, që cituat është një Drejtori e Shërbimeve Sociale në këtë bashki me 120 punonjës, të cilët në bazë të ligjeve në fuqi dhe ligjeve europiane që po shkojmë drejtë, bazohen tek protokollet e veçanta për secilin target grup, si për gra të dhunuara, si për aftësinë e kufizuar. Kështu që janë disa protokolle që në fakt, unë i kam gjetur të bëra në këtë drejtori dhe nuk mund të kthehemi hapa pas tani të diskutojmë diçka që Bashkia e Durrësit ka kohë që e ka strukturuar me protokolle edhe në bazë të ligjit.
Kështu që edhe për termin, për termin e shpjegova dhe po ju jua shpjegoj. Kur flasim për "transformimin gjinor" edhe një edhe njëherë, se më duhet ta ribëj këtë gjë nuk po flasim për transformimin burrë grua, grua burrë apo dhe po e thua me fjalën tënde që nuk do të diskriminosh askënd ndërkohë që po lufton që pse në renditjen e grupeve kemi shënuar dhe LGBT-në. Është transformim gjinor sidomos për gratë dhe po të keni qenë në dëgjesat e planit, që kanë qenë në fakt dëgjesa shumë serioze, me debat shumë të fortë që kanë zgjatur mbi tre orë në këtë sallë dhe janë bërë pothuajse katër deri në pesë dëgjesa dhe me grupet e interesuara dhe me gratë e dhunuara kanë qenë këtu prezent dhe Edlira ka qenë dhe e ftuar. Po rastësia e mbaj mend që nuk ka qenë në Durrës atë ditë, se kemi komunikuar bashkë që të ishe, kemi pasur debat madje dhe nga këshilltari që parafolës që u diskutua që pse flitet vetëm për gra dhe vajza, por realisht ky plan i mbështet edhe burrat. Se duke qenë se statistika na thonë që 45 ë burra apo djem kanë marrë urdhër mbrojtje, ata kanë qenë në strukturën tonë, kështu që mos hidhni poshtë punën e njerëzve që punojnë gjithë ditën aty. Plani është punuar me ekspertë ndërkombëtarë dhe jo vetëm me stafin e bashkisë.

Denisa Luarasi: Faleminderit drejtoresha.

Diola Xhango: Ju falenderoj.

Denisa Luarasi: Faleminderit.
Jo, replikë nuk ka. Do ta mbylli kryetari i grupit të Partisë Demokratike.

....flitet pa mikrofon njëkohësisht .....

Denisa Luarasi: Të lutem, tani kalojmë Edlira. Duhet të kalojmë në votim.
Kalojmë në votim.
Okej
Po, po Muka thërrite mikrofonin.

Edlira Devolli: Zonja drejtoreshe ...

Denisa Luarasi : Unë nuk jua dhashë fjalën, të lutem.
Unë ja dhashë fjalën Mukës nuk jua dhashë juve fjalë.

Edlira Devolli: Ka të bëjë me formimin tim... ka të bëjë....

Denisa Luarasi: Të lutem, lutem mos më shtypni mikrofonat gjatë gjithë kohës.
Nuk ta jap fjalën ja kam dhënë Mukës.

Edlira Devolli: Ti nuk ma heq dot fjalën këtu, në mënyrë absolute.....

Denisa Luarasi: Do ta pres.

....flitet pa mikrofon njëkohësisht .....

Ardian Muka: Në emër të grupit të Partisë Demokratike doja të falenderoja edhe ndërhyrjen që bëri kolegia Devolli dhe mënyrën se si ajo e shtroi problemin.
Tani duhet të jemi të qartë për vete, por edhe për qytetarët që na dëgjojnë. Kur flasim që ky projektvendim, që ka lidhje me planin vendor të veprimit të barazisë gjinore është i bazuar në ligj dhe me të drejtë drejtoreshë ju referua ligjeve europiane, strategjisë kombëtare, VKM-së numër 64/2025, datë 06.11.2025 në lidhje me ligjin "Për barazinë gjinore", o do bazohemi në ligj ose nuk do bazohemi në ligj. Nuk ka, kjo është vetëm për gratë e dhunuara, të trafikuara, po pjesërisht edhe për LGPTQ-në dhe pjesa tjetër nuk përfiton. Nuk është ashtu. Në qoftë se është kështu, është diskriminim për 41 kategoritë e tjera, të cilat i ka aprovuar ligji europian, sikurse i ka aprovuar dhe parlamenti shqiptar. Në qoftë se doni mund t'jua lexoj të 41-i, siç e lexoi eurodeputeti gjerman atje. Po besoj që të gjithë e keni parasysh se për çfarë bëhet fjalë. Prandaj në qoftë se do bazohemi në ligj nuk mund të keqinformojmë publikun duke i thënë kjo është vetëm për gratë e dhunuara, për gratë që janë në nevojë, por kjo ka lidhje me të gjithë kategoritë, pra për 41 kategoritë, të cilët kanë të drejta të barabarta të trajtohen para ligjit.
Si forcë e djathtë neve e kemi kontestuar këtë ligj në parlamentin shqiptar. E kontestojmë dhe sot këtë plan që na paraqitet. Jemi 100% dakord që neve të ndërtojmë një plan ndoshta vendor për trajtimin e të gjithë zonjave dhe zotërinjve dhe përsëris zonjave dhe zotërinjve, të cilat kanë këto probleme, kanë probleme trafikimi, kanë probleme pamundësie, financiare dhe të gjitha.
Në këtë mënyrë shpreh votën tonë kundra këtij plani që keni sjellë, ta ripunojmë, sepse ndryshe po bëni shkelje ligjore. Mënyra se si neve jemi informuar nuk është e vërtetë.
Ju faleminderit.

Denisa Luarasi: Ok, faleminderit. Kalojmë në votim.

Rolant Xhelilaj: Meqë foli në emër të komisionit, se unë së shparë fola në emrin tim.
Është justifikim gjithë qëndrimi i Mukës. Ai e kupton që ky plan është vetëm për këto kategori që mbulon bashkia. Atë problem që trajton.....

....flitet pa mikrofon njëkohësisht .....

Rolant Xhelilaj: O Muke, Muke vazhdo. Vazhdo.....
Ai e ka për justifikim konventat europiane dhe ligjin e shtetit, i ka me shumë dëshirë konventat europiane, miratimin e ligjit nga parlamenti e pranon, por e voton kundër, sepse nuk do trajtohen të gjithë. Nuk po dal as te shoqja parafolëse, që tha unë nuk jam kundër LGBT-së, por diskutimi në themel ishte aty.
Bashkia ka bërë një plan pune që përfshin këtë lloj kategorie, të hyjmë pastaj se aty të ishte shkruajtë janë 41 kategori apo s'janë 41 kategori, është justifikim për të votuar kundër.
Kalo në votim edhe qëndrimi i grupit tonë është pro këtij vendimi.

..... ndërkohë votohet elektronikisht....

Denisa Luarasi: *Me 25 vota pro, 1 abstenim dhe 10 kundër, nuk kalon.*
Pika 2 e rendit të ditës nuk kalon.
Atëherë i jepet fjala për projektvendimin....

....flitet pa mikrofon njëkohësisht .....

Denisa Luarasi: Të lutem Joniada.
Joniada, të lutem. Të lutem Joniada. Të lutem Joniada, të lutem Joniada.
I jepet fjala për projektvendimin e pikës.....
Joniada.....
I jepet fjala për projektvendimin e pikës 3, Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike.
Ua....!

....shumë zhurmë flitet njëkohësisht .....

Denisa Luarasi : Atëhere, 5 minuta pushim.
Pesë minuta pushim.

..... fillon mbledhja pas 15 minutash.....

Denisa Luarasi: Rifillojmë me mbledhjen. Jemi tek pika tre e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 3** Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëhere dhe pikën tre ne votuam dhe ftojmë këshillin japi votën pro. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.
Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor, zoti Hekuran Markola.

Hekuran Markola: Faleminderit.
Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor me shumicë votash e kalon për votim në këshill bashkiak.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Markola.
Komente, pyetje ka për pikën 3 të rendit të ditës?
Nuk.... Po, zonja Kola.

Flutura Kasa: Këto janë shtesat. Disa pika taksisht do rrinë ashtu siç kanë qenë? Për shembull tek Ura Dajlanit është një pozicion sa hyn me 5 taksi dhe ato kanë ngrejt këtë shqetësim që do jemi ne akoma këtu, me këto ndryshimet? Është te fastfood "Mario" që është sa hynë te Ura Dajlanit.

Denisa Luarasi: Nga administrata kemi?

Alda Zyferi: Okej, përsa i përket vendit të taksive janë të gjitha vende të miratuara që kanë qenë në VKB-n e mëparshme. Këto janë vendje plus. Duke qenë se kemi pasur shumë kërkesa nga subjektet dhe siç ju e shikoni tashmë numri i taksive është rritur në qytet dhe nuk ka një kufizim për këtë. Kemi menduar në bashkëpunim edhe me Ndërmarrjen Rruga, e cila na suporton provizimin dhe me Policinë Bashkiake disa hapësira të tjera për vendqëndrimi për taksi. Kjo edhe për shkak të kufizimit, që do t'ju bëhet me vizimet blu në disa hapësira të tjera.

Flutura Kasa: Faleminderit.

Alda Zyferi: Nëse do keni sugjerime të tjera për hapësira mund t'i diskutojmë në këshill, në vazhdim.

Flutura Kasa: Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit drejtoresha.
Atëherë kalojmë votim për pikën 3 të rendit të ditës.
Me 34 vota pro miratohet pika 3 e rendit të ditës pa ndryshime.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 4**, Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj

Joniada Musaraj: Atëherë dhe pikën katër ne e votuam pro dhe ftojmë këshillin që ta miratojë sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit.
I jepet fjala Komisionit të Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës zonjës Jonada Mamo.

Jonada Mamo: Përshëndetje.
Edhe komisioni jonë e votojm me shumicë votash dhe fton këshillin ta miratojë. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Mamo.
Komente, pyetje ka për pikën 4 të rendit të ditës?
Po Muka.

Edlira Shemsi: Po. Muka apo unë?
Po.

Ardian Muka: Jo. E don fjalën doktoresha?

Edlira Shemsi: Jo. Meqë herën e kaluar bëra një pyetje lidhur pikërisht me këtë, prandaj .....

Denisa Luarasi: Edlira të lutem, jo dy mikrofona të ndezur. Ta kam bërë vërejtjen është e treta herë. Ja dhashë fjalën Mukës, pastaj do ta jap ty.

Ardian Muka : Jo le të flasë doktoresha, se flasë në emër të grupit.

Edlira Shemsi: Po këtu flasin anëtar këshilli pa e shtyp fare, jo një herë, po 15 herë.

Denisa Luarasi: O Edlira

Edlira Shemsi: Për më tepër ma dha lejen kryetari i grupit.

Denisa Luarasi: Ok, vazhdo.

Edlira Shemsi: Jemi në rregull.

Denisa Luarasi: Vazhdo.

Edlira Shemsi: Ok po flas.
Herën e kaluar kisha drejtuar pyetje pikërisht lidhur me këtë pikë, duke e ditur që do vinte në këtë këshill kjo pikë për miratim, në lidhje me shpronësimet që do bëhen në rrugën e Curilave, që lidh rrugën ë Isuf Ferra me rrugën Aleksandër Goga. Dhe pyetja ime ishte: A ka një marrëveshje, një dakordësi me pronarët që do shpronësohen në banesa apo në shërbime?
Në fakt më vjen mirë se ka një reflektim. Në relacionin që kam lexuar i është bërë një modifikim projektit. Një pjesë e atyre që do shembeshin janë evidentuar që nuk do shemben më, por nuk është dhënë përgjigjja që a ka apo s'ka një dakordësi në lidhje me banorët, që si do jetë shpronësimi i tyre në lidhje me tregun imobiliar? A është një zonë që ka një zhvillim afatmesëm dhe afatgjatë që është në zhvillim si zonë, dhe si do shpronësohen këta?
Përgjigja që mu dha herën e kaluar nga drejtoresha juridike e bashkisë ishte që ligji për shpronësimet për interesa publike nuk e parashikon të merret dakordësia me banorët. Është pothuajse fiks i njëjti problem si me projektin TID. Sigurisht që duhet të merret dakordësia e banorëve se janë ata që e vuajnë siç dolën dhe protestuan dhe herën tjetër me 40 milionë të vjetra që kishin thënë njërit nga nga banorët tha ai .. “Unë s'blej dot një garsonier, si mund të blej më një shtëpi. Të dal me gjithë familjen jashtë...”, kështu që patjetër në qoftë se nuk është marrë

dakordësia e banorëve që ata të shpronësohen në bazë të të gjithë vlerës që ka tashi tregu imobiliar në atë zonë, që thashë është zonë në zhvillim, ne nuk mund ta miratojmë këtë pikë plus. Se ata janë ata që preken drejtpërdrejtë. Unë kështu e mendoj.
Ligji i vërtetë është një ligj që është miratuar, se edhe ligji është i padrejtë se është ligj komunist se vetëm komunisti ta merrte pronën pa asnjë lloj kompensimi të drejtë. Por ne këtu po flasim për banorë të Durrësit dhe po kërkohet nga këshilltarët këtu, që ta miratojmë atë pa marrë më parë dakordësinë e banorëve. Ata janë të majtë e të djathtë nuk ka të bëjë me partitë, ka të bëjë me banorët të Durrësit. Ne këtu jemi përfaqësues për të gjithë banorët. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Shemsi.
Po Muka mund ta mbyllësh.

Ardian Muka: Fakti që rikthehemi për ndryshime në VKB-në nr.6, që ne kemi aprovuar ose më sakt neve nuk e dhamë votën pro në atë moment me datë 10.02.2026, na jep të drejtë për votën tonë kundra në atë rast, ku natyrisht nuk ishte një votë kundra apriori, ishte një votë kundra e argumentuar kur thamë që, trakti i rrugës është i pastudiuar. Trakti i rrugës ka mundësi që mos t'i preki ato prona në mënyrën se si vinte ai propozim, duke shkuar duke prekur godinat e larta dhe nga krahu tjetër ku kishe mundësi që t'u spostonte dhe mund të prekte thjesht ndoshta oborret e qytetarëve. Pra, në kuadrin e shpronësimit është shumë më thjeshtë të shpronësosh një oborr sesa të shpronësosh një pallat me katër apo pesë kate, që ishin atje. Si dhe problematika të tjera, të cilat juve këtu pra, shmang prekjen e një numër ndërtesash disa katshe, u ngrit nga ne ky si problem, banesa e njësit tregtare u ngrit nga ne, ul ndjeshëm fondin e nevojshëm për shpronësim si rezultat do vinte kjo. Garanton përdorim më ekonomik dhe efikas të fondit publik në buxhetin e shtetit. Natyrisht që thashë në këtë pikë na vjen mirë që bashkia ka reflektuar, por nga ana tjetër nuk jemi dakort për mënyrën e kompensimit që i ofrohet atyre banorëve. Në momentin e parë jeni referuar VKM-së numër 138/23.03.2000, përsa i takon shpronësimit të banorëve. Aktualisht vini me propozimin që këto banorë do të shpronësohen me një VKM nr 89, datë 03.02.2016. Që ne mos të krijojmë probleme sociale siç kemi hapur dhe bllokime ndërkohë të projektit në bashkinë e Durrësit siç kemi bllokuar dhe problemet sociale që kemi hapur me banorët e projektit TID, neve si grup, si forcë e djathtë, besoj flas në emër të gjithë opozitës, propozojmë që këta banorë siç reflektuat për këto ndryshime që keni bërë dhe që janë bërë më mirë se ç'ishin, të shpronësohen sipas vlerës së tregut. Në këtë mënyrë neve nuk do kemi konfliktin që kemi aktualisht në disa zona, por kryesisht flasim për projektin TID, që kemi më të ndjeshme dhe ky projekt do ketë mundësi që të shkojë përpara pa pasur konflikte dhe probleme sociale të shtuara. Ju faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Muka.
Nëkryetar do flasësh? Jo.
Atëherë kalojmë votim.
Me 27 vota pro dhe 8 kundra miratohet pa ndryshime pika 4 e rendit i ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 5**, Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Edhe pikën pesë ne si komision e votuam pro dhe ftojmë këshillin ta miratojë sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit.
E merr fjalën Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit Të Tokës, zonja Joniada Mamo.

Jonada Mamo: Vetëm një saktësim të lutem, Jonada, se do më thërrasësh prapë.

Denisa Luarasi: Jonada.

Jonada Mamo: Edhe komisioni jonë e votojë me shumicë votash dhe fton prap këshillin për miratim. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit.
Komente, pyetje ka për pikën 5 të rendit të ditës?
Kush? Thërrite mikrofonin Muka se...

Ardian Muka: Me të njëjtin argumentim si dhe në pikën katër do thoja që dhe në këtë rast meqënëse diskutohet për një shpronësim në zonën Ishëm, në njësinë administrative Ishëm do të propozonim që trajtimi që i bëhet qytetarëve që të shpronësohen, të merret për bazë vlera e tregut dhe jo mënyra se si janë bërë përlllogaritjet për shpronësimin e tyre. Ju faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Muka.
Komente të tjera ka?
Po thërrite, po Markola.

Hekuran Markola: Është e dyta herë që thotë vlera e tregut. Po vlera e tregut nga kush përcaktohet? Përcaktohet nga shit-blerjet e gjashtë muajve të fundit nga ASHK-ja dhe të jeni të sigurtë që po të merret kjo, do të dalë më ulët sesa VKM-ja. Prandaj kush e përcakton vlerën e tregut?

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Markola.
Tani nuk...
Kalojmë në votim.

....flitet pa mikrofon njëkohësisht .....

Denisa Luarasi: Tani të kalojmë votim

....flitet pa mikrofon njëkohësisht .....

Denisa Luarasi: *Me 26 vota pro, 1 abstenim dhe 8 kundra miratohet pa ndryshime dhe pika pesë e rendit të ditës.*

- I jepet fjala për projektvendime e **pikës 6** Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Edhe pikën gjashtë ne e votuam pro dhe ftojmë këshillin ta miratojë sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit.
E merr fjalën Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Marsida Feshti.

Marsida Feshti : Përshëndetje.
Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike, është dakord që pika gjashtë të kalojë për votim në këshill. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Feshti.
Komente pyetje ka për pikën 6?
Nuk ka. Kalojmë votim.
Me 33 vota pro, 2 abstenim, miratohet dhe pika 6 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 7,** Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë dhe pikën shtatë ne e votuam pro dhe ftojmë këshillin ta miratojë sot.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.
Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Marsida Feshti.

Marsida Feshti. Edhe për pikën shtatë, Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publik është dakord të kalojë për miratim në këshill. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Feshti.
Komente, pyetje ka për pikën shtatë rendit i ditës?
Nuk ka. Kalojmë votim....
Me 34 vota pro, 1 abstenim, miratohet dhe pika 7 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 8**, Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë dhe pikën tetë ne votuam pro dhe ftojmë këshillin ta miratojë sot.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.
Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike zonja Marsida Feshti.

Marsida Feshti: Edhe për pikën tetë Komisioni i Strehimeve dhe Shërbimeve Publike është dakord të kalojë për miratim në këshill. Faleminderit.

Marsida Feshti Faleminderit zonja Feshti.

Komente, pyetje ka për pikën 8?
Nuk ka. Kalojmë në votim.
Me 35 vota pro miratohet pika 8 e rendit i ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 9**, Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj

Joniada Musaraj: Atëherë dhe pikën nëntë ne e votuam pro dhe ftojmë këshillin ta miratojë sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.
Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike zonja Marsida Feshti.

Marsida Feshti: Edhe Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort që të kalojë për miratim sot në këshill. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Feshti.
Komente, pyetje ka për pikën 9 të rendit të ditës?
Nuk ka. Kalojmë votim elektronik.
Me 35 vota pro miratohet dhe pika 9 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 10,** Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Edhe edhe pikën 10 komisioni ynë e miratoi dhe ftojmë këshillin që të japi ok sot, ta votojë pro.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.
Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike zonja Marsida Feshti.

Marsida Feshti: Edhe Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike për pikën 10 është dakord të kaloj sot për miratim në këshill. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Feshti.
Komente pyetje ka për pikën 10?
Jo. Kalojmë në votim elektronik.
Me 35 vota pro miratohet dhe pika 10 e rendit të ditës.

Edlira Shemsi: Voten e dhashë pro bashkë me anëtarët e tjerë të grupit, sepse është për t'i dhënë banesë qytetarëve nga ndërtimi që bëhet post tërmetit. Po herën e kaluar bashkë me përfaqësuesin e bashkisë unë diskutova në lidhje me pallatin 901 tek shkolla Naim Frashëri për të cilin do merret një vendim i ri, por nuk e shoh të evidentuar këtu në këtë listën e këtyre banesave që do të rishikohet se si do të procedohet më tej me ndërtimin e tyre. Ai pallat që fillimisht u tha do të rindërtohet nga banorët, ju dha 2.5 milion lekë të vjetra, pastaj tha do shëmbet dhe ka ngelur standby gjithë kjo periudhë ec-ik nëpër bashki qytetarët, të cilët paguajnë ato qerat nga xhepi i vetë, dhe janë pothuajse të gjithë, janë pensionistë në atë pallat dhe u tha që ai është biseduar dhe

njëherë me këtë pallat me Institutin e Ndërtimit dhe do lëvrohet fondi nga buxheti i ndërtimit sa më shpejt të jetë e mundur. Nuk e shoh të evidentuar këtu dhe shpresoj që të rishikohet sa më shpejt, se ata vazhdojnë paguajnë qera, nuk futen dot në shtëpi dhe nuk dinë çdo bëhet me pallatin për të cilin është thënë që do riforcohen kolonat. Faleminderit.

Denisa Luaras Faleminderit. Zonja Harizi.
Nëse drejtoresha ka ndonjë koment, po ashtu kalojmë tek projektvendimi.
Po, drejtoresha.

Alda Zyferi: Është i njëjti informacion për të shtata pallatet, të cilët nuk kanë një miratim financimi. Ka ardhur vendimi i KSHR-së në rrugë elektronike pasi e kërkuam pas mbledhjes. Nuk na është depozituar akoma në mënyrë zyrtare shkresore dhe më tej do ta shqyrtojmë pjesën e financimit për të shtatë pallatet. Sot nuk po diskutojmë, sot nuk jemi në diskutim të ribuxhetimit, sot jemi në diskutim të përfituesve për pjesën e tërmetit.

Denisa Luarasi: Faleminderit drejtoresha.
Kalojmë te pika 11.

- Kalojmë tek projektvendimi i **pikës 11**, Komisioni Rregullores, Çështjeve Juridike, zonja Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj : Atëherë dhe pikën 11, ne e votuam pro dhe ftojmë këshillin që ta miratojë sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.
Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Marsida Feshti.

Marsida Feshti : Edhe për pikën 11, Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakord që të kalojë sot për miratim në këshill. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Feshti.
Komente pyetje ka për pikën 11?
Nuk ka. Kalojmë votim elektronik.
Me 35 vota pro miratohet pa ndryshime dhe pika 11 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 12** Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj : Edhe pikën 12 ne votuam pro dhe këshillit i kërkojmë sot që të japi miratimin e tij.

Denisa Luarasi: Faleminderit. Zonja Musaraj.
Komisioni i Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave zoti Rolant Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj : Edhe Komisioni i Buxhetit me vota unanime e kalon këtë pikë për miratim në mbledhjen e Këshillit Bashkiak.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Xhelilaj.
Komisioni i Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë, zonja Mirela Shala.

Mirela Shala: Përshëndetje.
Edhe komisioni ynë miraton pro pikën 12 dhe ftojmë këshillin për votim.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Shala.
Kalojmë votim. Më fal, ka pyetje, komente, kemi për këtë pikë?
Nuk ka. Kalojmë në votim elektronik.
Me 35 vota pro miratohet dhe pika e 12 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 13,** Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë dhe pikën 13 ne e votuam pro si komision dhe ftojmë këshillin që t'japi miratimin sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.
Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit zoti Kastriot Xhongoli.

Kastriot Xhongoli : Edhe për pikën 13 komisioni votoi pro dhe ftojmë këshillin ta miratojë.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Xhongoli.
Komente, pyetje ka për pikën 13 të rendit të ditës?
Po. Po zoti Çuni.

Llesh Çuni: Atëherë së pari në emër të banorëve të Manzës, dua t'i bëj një falenderim publik kryetares së bashkisë, zonjës Emiriana Sako, që bëri të mundur ndërtimin e atij gjimnazi të ri me standarte bashkëkohore në vendin e gjimnazit që u dëmtua totalisht nga tërmeti. E them këtë, sepse në atë kohë ishim shumë mosbesues dhe një ndër këta mosbesues isha dhe unë personalisht, sepse kishte hamendësime sikur nuk do të bëhesh më ky gjimnaz. dhe gjimnazistët e Manzës do të atashoheshin ose në një shkollë të Kullës edhe ajo për fat të mirë domethënë është një godinë shumë moderne, por i shuajti të gjitha këto hamendësime zonja Sako duke ndërtuar një gjimnaz të ri me standarte thashë tejet bashkëkohore.
Së dyti unë sot me rastin që asaj shkolle apo atij gjimnazi do t'i jepet emri i një mësuesi të nderuar të zonës time të ndjerit Enver Farruku, një mësues model që ka një kontribut të çmuar në shumë shkolla të zonës, por ndihem krenar sot, sepse unë jam një nga ish-nxënësit e tij.
Së pari dhe së dyti kjo krenari më shtohet më shumë, sepse do të jem një ndër 51 këshilltarët që do ta përjetësojë emrin e tij te ai gjimnaz. Por këtu desha të sugjeroj diçka. Administrata që do të merret më vonë pas miratimit të këtij vendimi nga ana jonë duhet të bëjë kujdes, sepse në Manzë tek hartimi i pllakatës se si do ta mendojnë ata në shkrimin e emrit, sepse ne në Manzë kemi dy persona me të njëjtin emër. Enver Ahmet Farruku që është personi emrin e të cilit do të marrë

gjimnazi dhe një Enver Rexhep Farruku që jeton, por njeri shumë i ndershëm, i nderuar në zonë, por që s'ka lidhje me projektvendimin. Prandaj duhet cilësuar, mendoj unë edhe atësia duke qenë dy persona me të njëjtin emër dhe të njëjtin mbiemër. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit. Patjetër do ta kenë sugjerim.

Ilir Paja : Emri i babait nuk vehet.
Me sa di jo.

Denisa Luarasi: Po Muka.

Ardian Muka: Po marr shkas nga këshilltari zoti Çuni. Meqënëse në projektvendim propozohen dy emërtime. Propozohet emërtimi i gjimnazit dhe i një rruge me të njëjtin emër. Pra për zotin Enver Farruku. Mos kemi të bëjmë që rruga është Enver Farruku tjetër dhe gjimnazi është mësues i nderuar që e thotë zotëria, për ta saktësuar këtë, se pastaj ndoshta mos kemi përplasje. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Ka ndonjë nga Drejtoria e Arsimit nga administrata.

Migena Muhaj : Ajo është e sqaruar, nuk besoj se ka nevojë për të sqaruar më, që bëhet fjalë për të njëjtin zotëri, që në nder të tij të emërtohen të dyja. Po që është rruga drejt po, që shkon drejt shkollës.

Denisa Luarasi: Okej, faleminderit.
Kalojmë në votim.
Me 33 vota pro miratohet dhe pika e 13 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 14,** Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë dhe pikën 14 ne votuam pro dhe ftojmë këshillin që ta miratojë sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.
Komisioni i Zhvillimit Urban Përdorimit i Tokës, zonja Jonada Mamo.

Jonada Mamo: Përshëndetje.
Edhe komisioni jonë e miratojë me shumicë votash dhe fton këshillin ta miratojë tani. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Mamo.
Komente, pyetje ka për pikën 14?
Po Muka. Muka, të lutem thërrite mikrofonin. Do flasësh?
Okej, faleminderit.
Atëherë kalojmë në votim.

Me 33 vota pro miratohet pa ndryshim dhe pika 14 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 15**, Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj .

Joniada Musaraj: Atëherë dhe pikën 15 ne e votuam pro dhe e ftojmë këshillin që ta miratojë sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.
Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit zoti Kastriot Xhongoli.

Kastriot Xhongoli : Edhe për pikën 15 komisioni e votoi pro dhe ftojmë këshillin ta miratojë.

Denisa Luarasi: Faleminderit.
Pyetje, komente ka për pikën 15?
Po Muka.
Ju lutem mikrofonin Muka.

Ardian Muka: Për pikën 15 natyrisht kisha një koment, në princip jemi dakort, sepse kur diskutohet për sportin, unë isha pjesë edhe e dëgjesës publike që bëmë me pjesën e sportistëve dhe trajnerëve të Klubit të Shumësportësh, por edhe të atyre të cilët janë shoqata të atashuara pranë bashkisë së qytetit tonë. Një nga kërkesat që u ngrejt me të drejtë nga ana e bashkisë i takon institucionalizimit. Pra, shumë nga këto shoqata apo sportistë dhe trajnerë, të cilët për fatin tonë të qytetit, por që pak vetë e dinë, besoj edhe në këshillin bashkiak, neve në qytetin tonë kemi nënkampion bote, kemi kampion europe disa, i kemi kampion ballkanik dhe kampion kombëtar dhe për fat të keq shumë pak këto arrijnë që neve t'i lançojmë dhe këto të jenë figura, të cilat të jenë publike. Janë nderi i qytetit. Po flasim kampion botëror, europian dhe ishin disa.
Për fat të keq edhe unë aty e mora vesh diç njoh prej atyre, por njoh për marrëdhënien personale që kemi. Dhe të kesh një elitë të tillë në qytetin e Durrësit dhe ato të vijnë dhe të dëgjoje se çfarë ata kërkojnë, janë kushte elementare dhe për ne si këshill me thënë të drejtën, unë për vete ndjeva turp atë ditë. Prandaj do ju ftoja me patjetër këtë libër projektvendim që neve na vjen, neve duhet ta kalojmë, por duhet ta shohim në syrin që ata çfarë kërkojnë. Kërkonin thjeshtëzim të procedurave. Pra kemi parasysh janë sportistë, janë dhe njerëz që ndoshta nuk janë të formuar në shkollën, në arsimin e lartë dhe të gjitha. Por nga ana tjetër ato janë janë profesionistë në fushën e dytë.
Duhet ta mbaroj të lutem, më leni dhe një minutë më tepër, se nuk besoj që është fundi i botës. Kërkuan ndryshimin e ligjit të sporteve. Natyrisht kjo nuk na takon ne. Është diçka që është pjesë e qeverisë dhe në bazë të asaj pastaj neve nxjerrim edhe pjesën e vendimeve si këshill, por ata e shohin të keqen direkte këtu, si te ligji 139 që ka lidhje me vetëqeverisjen vendore. Kërkonin mbështetje logjistike, kërkonin dhe mbështetje financiare.
Përsa i takon mbështetjes logjistike, një nga propozimet që unë do të bëja, e kemi ngritur që në krye të herës, do të ishte që shumë sporte duke filluar shtanga, duke filluar pingpongu, duke vazhduar me bodybilding, janë të gjithë sporte elitare. Thashë, ishin njerëz të cilët janë rekordmen europian dhe botëror, nuk kanë ku stërviten, stërviten nëpër garazhe makinash, stërviten nëpër

ambiente jo adekuate dhe do ishte në nderin tonë që t'i jepnin këtyre njerëzve mundësinë nga ana logjistike. Kjo është detyrë e bashkisë nuk është që mund ta zgjidhin të paktën me ligjin aktual të sporteve, nuk mund ta zgjidhin dot ndryshe.
Propozimi im do ishte që në projektin që neve kemi për stadiumin e Durrësit ku kemi propozuar nga ana e bashkisë të ndërtohen hotele 30, 40 katëshe, të ndërtohen zona rekreative, të ndërtohen molle. Ata njerëz kërkonin të kenë sipërfaqe ku të stërviten. Prandaj i pyeta në sy ato, ju bëjnë punë juve hotelet, ju bëjnë punë qendrat komerciale që ne ndërtojmë atje? Jo vëlla tha, neve duam që të ushtrojmë atë çfarë është.

Denisa Luarasi: Ishim prezent në dëgjesë nuk e dëgjova këtë pyetje.

Ardian Muka: Ju ishit, unë po e flas për pjesën tjetër se për fat të keq ishim shumë pak. Të ishim atë dite të gjithë besoj që do ishim më të sensibilizuar për këtë pjesë

Denisa Luarasi: As garazh makine nuk dëgjova.

Ardian Muka: Pra do propozoja që në projektin t'u shihte mundësia e ndryshimit ku të gjitha sportet të këtyre personave, të cilët janë kampionë, por jo vetëm, të trajtoheshin me sipërfaqe, me ambiente adekuate për të ushtruar sportet. Duhet të kemi parasysh që sporti është ekonomi, është turizëm, është dhe zgjidh shumë probleme sociale. Prandaj duke votuar këtë ligj, thashë jemi dakord që neve ta kalojmë këtë pjesë, por duhet të kemi parasysh që të bëjmë ndryshimet në mënyrë që këta njerëz, që janë elita e qytetit, për sytë e rinisë, por jo vetëm, neve t'i shohim dhe t'i japim atë çfarë meritojnë. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Po zoti Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Meqënëse te ai projektligji që dolëm ishin kundër Mukës, t'i japim një mbështetje, është diskutim i gjatë po i saktë, i mirë. Është opinioni i të gjithëve edhe i joni, që Klubi Shumësporteve duhet të ndihmohet nga bashkia të jetë në vëmendje, në vazhdimësi por i mbështetur në ligjin e sporteve, që duhet të kalojë nga parlamenti. Në këto kushte të gjithë grupi i këshilltarëve të PS voton këtë projektvendim dhe është dakord me vëmendje specifike për sportet në qytetin e Durrësit.

Denisa Luarasi: Faleminderit z.Xhelilaj.
Kalojmë në votim.
Me 33 vota pro miratohet dhe pika e 15 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 16**, Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë dhe pikën 16 ne e votuam pro dhe ftojmë këshillin që ta miratojë sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.
Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave, Tarifave zoti Rolant Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Ne e kalojmë me votën unanime për në këshill bashkiak dhe kërkojmë miratimin nga të gjithë anëtarët e këshillit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Xhelilaj.
Komente, pyetje ka për pikën 16?
Po Muka.

Ardian Muka: Tani me thënë të drejtën të diskutosh për dy minuta apo tre minuta këtë pjesë është pak sfidë. Megjithatë unë do përpiqem t t'i përmbledh.
Isha pjesë edhe e dëgjesës që bëmë për pjesën e e buxhetit afatmesëm. Natyrisht qyteti ka shumë shumë sfida përpara për të përballuar, por besoj që të paktën nga ana jonë neve do përpiqem të japim kontributin tonë nëpërmjet vërejtjeve, propozimeve, sugjerimeve, që mund të bëjmë, sepse opozita këtë e ka në dorë. Natyrisht pastaj i takon bashkisë të marri parasysh ato çfarë neve do propozojmë e do themi.
Për fat të keq ky material që na është propozuar është një copy paste e shumë materialeve të tjera siç na vijnë përsa i takon pjesës buxhetit e kam konfrontuar me të paktën dy të tjera. Megjithatë e ndryshojnë thjesht pjesa e numrave, por koncepti është po ai.
Do përqëndrohem tek pika katër, buxheti i afatmesëm i bashkisë Durrës. Në këtë seksion projektet kryesore të investimeve në fondet e bashkisë për vitin 2027-29 janë: rikonstruksioni i pallatit të sportit Ramazan Njala, ndërtimi i ri i godinave shkollës Vasil Ziu, Nën Tereza, gjimnazi Gjergj Kastrioti, ngritja kopsht, pallate rindërtuar në kuadër procesit rindërtimit zonë e ujësjellësit. Vazhdojmë me rikonstruksionin të rrugëve në qytet dhe njësitë administrative, rehabilitim kuartallesh, rehabilitim në rrjetin ndriçues, si dhe shtim të sipërfaqeve të gjelbërta .
E thënë kështu është pak apriksomative, domethënë thuhet diçka që është shumë shumë e përgjithshme. Besoj që qyteti ka problematikën e përmbytjes, e cila neve i dimë tashmë kush janë problematikat. Natyrisht pas ndërhyrjes që bëri bashkia në gjithë sistemin e kanalizimeve besoj që, uroj natyrisht edhe që mos të kemi më ato problematika që kemi përsa i takon përmbytjeve, por problematika kryesore përsa i takon nuk është thjesht që neve do t'i mbledhim dhe do t'i çojmë më mirë. Problem kemi hidrovorin, kemi dhe kanalin e ujërave të larta. Në qoftë se neve nuk do ndërhyjmë në këto dy vepra tek hidrovori dhe kanali i ujërave të larta, do kemi përsëri problematika, që do kthehemi dhe duhet të aprovojmë fonde, si fondet që kaluam dy pika më sipër.
Kam qenë pjesë e disa publike. Një nga ato që është relativisht interesante ka lidhje me trajtimin e mbetjeve në qytetin tonë. Kalojmë nga trajtimi i mbetjeve me trajtim normal dhe djegie. Insistoj, them dhe djegie, tek riciklimi. Natyrisht kjo është një revolucion. Po flasim për anën e trajtimit nga ana e bashkisë. Për mua duhet të ishte pjesë e kësaj buxheti të afatmesëm parashikimi. Meqënëse ato propozojnë që nga viti i ardhshëm mbledhja dhe trajtimi i mbetjeve në qytetin e Durrësit do të ndryshojë, pra do kalojë pjesërisht edhe në pjesën e riciklimit.
Shtimi i sipërfaqeve të gjelbërta, duke pasur parasysh betonizimin, natyrisht këtu përmendet që do kemi për rivitalizimin e kuartalleve, por ajo që do propozoja do ishte që neve duhet të kemi patjetër krijimin e disa parqeve, sepse përndryshe do vuajmë nga problematika, që po i shohim sot e kësaj dite që po përballemi.

Problematikat e ujit të pijshëm dhe trajtimi i ujërave të ndotura. Natyrisht qyteti jonë e kemi treguar si brenda qyteti, sa herë që bie shi kemi problematika me anën e tërheqjes së ujërave të shiut automatikisht, sepse ato përzihen me ujërat e ndotura dhe për trajtimin e ujit të pijshëm për banorët kemi marrë fonde pafund, kemi bërë një ujësjellës të ri, ndërkohë që të gjithë jemi dëshmitarë që neve nuk kemi ndonjë përmirësim përsa i takon sistemit të furnizimit me ujë në banesat tona. Jemi në po ato nivele, mund të kemi një orë ujë më shumë.
Kam theksuar disa herë, meqënëse diskutohet për buxhetin, përsa i takon pjesës së trajtimit të sipërfaqeve të plazheve, neve bëmë një eksperiment, jemi akoma brenda eksperimentit ku nga ana e qeverisë me një VKM ju hoq e drejta që të kenë kush kërkon sipërfaqe plazhi dhe në atë rast bashkia do kishte një të ardhur dhe natyrisht do ishte më i monitoruar sipërfaqet e plazhit nga VKM-ja e qeverisë. Është thënë dhe tashmë është ligj prej një viti që kam të drejtë vetëm hotele të cilët janë në zonën e plazhit të kenë sipërfaqe. Automatikisht kjo u përkthye në një rënie të buxhetit të bashkisë. Automatikisht do kemi rënie dhe në fushën e investimit. Pra do kemi më pak fonde, më pak investime. Nga ana tjetër ishte sfidë besoj për punën e bashkisë që të kontrollonte sipërfaqet që ngelën të paadministruara ku në syun e të gjithë qytetarëve është parë që i gjithë bregdeti i Durrësit ishte i mbushur me çadra dhe inkasimet që ne kemi në bazë të ligjit ishin 70 në favor, 70, 30 në favor të publikes në këtë rast nga 60, 40 që ka qenë raporti në favor të privates. Do propozoja, sepse është diçka që e ndeshim përditë shumë grupe turistike, të cilat gjatë periudhës së verës, por jo vetëm, vizitojnë qytetin tonë janë të çorientuara përsa i takon objekteve për t'u vizituar. Duhet të kemi parasysh që fati jonë është që në harkun e 200 m nga bashkia me një rreze 200 metrash, janë rreth 20 objekte të rëndësishme historiko-arkeologjike për t'u vizituar. Natyrisht nga bashkia mund të thonë që ekziston një hartë, për mendimin tim duhet të jetë e aksesueshme në rrugë dhe në mënyra të tjera. Do sugjeroja që për këtë rreze, nga ana e bashkisë ndofta mund t'u jepte internet falas, këtu hyjmë në atë konceptin e smartcity me këtë rreze nuk ka nevojë më shumë, ku turistët të kenë mundësi që të hyjnë në sajtin e bashkisë dhe nëpër sajte ndoshta dhe private, të cilët e lançojnë këtë dhe të kemi mundësi që të jenë të vizitueshme nga ana e e turistëve, të cilët vijnë autonomë, që mund mos kem ndoshta një guid që mund t'i përcjelli. Të gjitha ato që thashë, natyrisht janë pjesë e asaj që është jeta e qytetit sociale ekonomike të gjitha dhe duhet të ishim pjesë në buxhetin afatmesëm, këtu thashë afatmesëm flitet për dy vite dhe ato që janë lënë si detyra janë këto katër pika që unë lexova më përpara.
Një vërejtje, po që këtë nuk e di, thashë unë jam urbanist, nuk hyn në aspektin ekonomik, por tek tabela e faqes 15, kemi faktin e 2025-s të realizuara 7 milion 695.859 këto janë miliard, pra sepse janë tre zero mbrapa, pra janë 7 miliard 695, ndërkohë që plani fillestar dhe plani i parashikuar për 2026 është 6 milion më falni, 6 miliard 852, pra janë rreth 1 miliard lekë më pak. Ndërkohë që bashkia natyrisht diskuton që ne kemi rritur performancën, rritet turizmi, rritet mbledhja e taksave dhe tarifave dhe pretendimi për 2026-n jemi 1 miliard lekë më pak se 2025-n dhe në të njëjtën mënyrë vazhdon edhe planifikimi për 2027-n, 2028-n dhe 2029-n, jemi nën atë ç'është fakti i 2025-ës. Për këtë do të doja një interpretim pastaj nga ana e sektorit ekonomik të bashkisë. Për këto që thashë kanë lidhje që është një sugjerim që ne duhet t'i marrim parasysh ato çfarë janë ato flagred, red flagët e qytetit në mënyrë që mos të përballemi pastaj me problematikat akute që na lindin gjatë gjatë vitit. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Muka.
E ka kërkuar fjalën drejtoresha.

Pastaj me rradhë.

Alda Zyferi : Neve e diskutuam pak në dëgjesën publike edhe me zotin Muka.
Unë mund të bëj vetëm një përmbledhje, jo për replikë, por më shumë për pjesën tjetër që nuk ishte. Tek ky plan buxhet ka një fond të dedikuar për infrastrukturën kulluese plus atyre që ju sipër thatë. Dhe përsa i përket edhe terreneve sportive që diskutuat pak më sipër, neve kemi konsideruar dhe rehabilitim sheshesh. Përsa i përket terreneve sportive ë kemi investuar në disa njësi, jo vetëm për ata të cilët janë profesionistë, por edhe për komunitetin, i cili mund ta përdori këto ambiente të dedikuara. Disa prej tyre janë multidisiplinore, disa janë vetëm për pjesën sportive. Një prej tyre me parametra goxha të larta për pjesën sportive do jetë edhe fusha në Katundin e Ri, fusha sportive. Por patjetër që do ketë dhe investime të tjera në njësi, të cilat nuk kemi investuar. Aktualisht kemi një investim në Shën Vlash edhe në fushën në Xhafzotaj, e cila mund të përfundojë për rreth një muaj.
Përsa i përket ë pjesës tjetër për ujin e pijshëm, neve na është prezantuar një master plan nga AKU, e cila përfshin investime jo vetëm në ujin e pijshëm në të gjithë territorin e qytetit të Durrësit, por dhe në përmirësimin e kanalizimeve të cilët mbikëqyret nga ata. Për këtë...

Ardian Muka: Çfarë vlerash?

Alda Zyferi : Ata nuk kanë një vlerë, sepse kanë paraqitur komplet projektin. Është një financim me bankën botërore. Do të thotë një financim i madh. Gjithsesi mund t'ju bëjmë një prezantim në çdo moment të asaj që na është prezantuar. Do të fillojnë në mos gaboj, fillimi është në 2027-ën, është i ndarë në lote dhe në zona të caktuara. Dhe përfshin dhe ujin e pijshëm dhe kanalizimet. Përsa i përket infrastrukturës kulluese, aktualisht në fondet e trashëguara kemi një ndërhyrje tek zona pranë zjarrëfikëses, ku e kemi konstatuar si zonë kritike. Kemi ndërhyrjen në shëtitoren Taulantia dhe kemi dhe ndërhyrjen që po bëhet në hyrjen kryesore të qytetit rruga Adria. Këto të paktën janë konsideruar emergjente për të pasur një farë përmirësimi në pjesën e përmbytjes për kanalizimet e mbyllura. Ndërkohë me fondet e trashëguara kemi futur dhe pastrimin e kanalizimeve për pjesën të cilën nuk e përfshin UKD-ja për pjesën ekzistuese. Do të thotë sipërfaqen dhe territorin, të cilën ata e kanë përfshirë në buxhetin e 2026-ësh që është ezauruar. Pjesën tjetër do pastrohet dhe do mirëmbahet nga ana e bashkisë.
Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit drejtoresha.
Po Edlira.

Edlira Shemsi: Në lidhje me buxhetin, gjithmonë buxhetin afatmesëm, a ka një fond në lidhje me transportin urban në drejtim të rritjes së linjave, por dhe të fashave orare, sidomos në sezonin veror kur Durrësi është kaq i populluar dhe nga turistët? Pasi ndërkohë që bashkia ka nxjerrë vendimin për parkimet duhet të tregojë edhe çfarë fondi ka për të rritur transportin dhe për të përmirësuar transportin urban në drejtim, si të shtimit të linjave, por edhe të fashave orare të tij. E para dhe e dyta. A ka një fond në lidhje për banesat sociale pasi për katër vite akoma nuk është dhënë asnjë banesë sociale, vazhdojnë të marrin vetëm ata që kanë qenë në listat ekzistuese, por edhe fonde për bonuse qeraje për familjet në nevojë ekonomike?

Në pikën 11 ishin disa familje sot dhe sigurisht unë votova pro bashkë me anëtarë të tjerë të grupit, por nuk u dha sqarim. Në fakt që, sa janë kërkesat edhe për bonuse qeraje, por edhe për banesa sociale, të cilat nuk është dhënë asnjë? Por edhe bonus qeraje për në dijeninë time për aq sa kam marrë informacion, kërkesat janë shumë më të shumta ngaç është në fakt ajo pjesa e financës që jepet për këto bonuset e qerasë. Këto janë. Çfarë vendi zenë në buxhetin afatmesëm, fuqizimi i transportit publik dhe për banesat sociale, por për bonus?

Denisa Luarasi: Faleminderit. Shumë qartë, u kuptua pyetja.
Ndonjë nga administrata? Nënkryetar?

Gentian Kallmi: Përshëndetje.
Faleminderit për pyetjen. Përsa i përket për banesat sociale, aktualisht ne jemi në përfundim të procesit të rindërtimit dhe banesat e mbetura do shikohen me përparësi për të zgjidhur një pjesë të mirë të çështjeve të strehimit social. Ndërkohë nga ana tjetër lidhur me përmirësimin e transportit Ju siç e dini që ekziston dhe një vendim të këshillit bashkiak i miratuar për subvencionimin e shoqërive, të cilat duhet të plotësojnë disa kushte, duhet të respektojmë frekuencat, por nga ana tjetër jemi në fazë studimi dhe me një projekt të detajuar nëpërmjet me ndihmën e bashkëpunim me GIZ-in për ta zhvilluar dhe ta përmirësuar transportin publik.

Denisa Luarasi: Faleminderit nëkryetar.

Gentian Kallmi: Po janë parashikuar në projektbuxhet.

Edlira Shemsi: Sa është pak a shumë?

Gentian Kallmi: Është e detajuar në listën e projektbuxhetit.

Denisa Luarasi: Faleminderit nënkryetar.
Pyetje të tjera ka?
Po zoti Markola.

Hekuran Markola: Faleminderit.
Atëherë projektbuxheti i afatmesëm është një farë mënyre një projektbuxhet në makro, jo në mikro siç referohen dhe të gjitha sugjerimet që u thanë këtu mund të orientohen edhe në dëgjesat publike tek projektbuxheti i vitit që vjen pasardhës. Desha të sqaroj, u tha që janë ripërsëritur disa herë, normal që do përsëriten disa të dhëna, sepse për shembull vitin 2026 ka tre vite që e kalojmë vit pas viti. Për , pse faktiku i 2025-s është 77 miliard realizimi dhe teoriku i 2026-s, duhet të kuptojmë se këtu kemi të bëjmë me një plan faktik që ka ndodhur, ndërsa 2026 është një plan teorik që akoma nuk është mbyllur dhe mund të jetë 82 miliard, jo 77. Dhe këtë gjithmonë e bëjnë këtë gabimin që krahasojnë planin faktik me planin teorik. Teoria është teori, faktiku është fakt. Ka ndodhur. Kjo ishte sqarimi.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Markola.
Kalojmë në votim.

Ardian Muka: Nga ana e bashkisë. Pyetja ime ishte konkrete. Thashë, meqënëse shohim që në vitin 2025 ne kemi një realizim, 2026-ën, meqenëse realizimi dhe gjithë pjesa e buxhetit del pasi neve shohim sa kemi realizuar, si ka mundësi që 27, 28, 29 janë më pak se 25? Kjo është pyetja ime. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit.
Kalojmë në votim.
Do ta sqarosh nënkryetar?
Po të lutem Hekura.
Nënkryetari atëherë.

Gentian Kallmi: Siç e dini buxheti i bashkisë nëpërmjet fondeve të tjera përbëhet edhe nga taksa dhe tarifa të ndryshme. Taksa e ndikimit në infrastrukturë është e paparashikueshme. Në vitin 2025 ju e keni bazën faktike të vjeljes së taksës në ndikimi në infrastrukturë. Projektbuxheti i afatmesëm është një projektbuxhet, i cili do të kalojë në këshill me miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2027, ku të dhënat do të jenë më reale dhe më të sakta dhe është një projektim të ardhurash, që do të reflektohen në mënyrë të saktë në momentin e miratimit të buxhetit.

Denisa Luarasi: Faleminderit nënkryetar.
Kalojmë në votim.

Flutura Kasa : Po kam diçka të lutem.
Mos e hap mikrofonin. Leje për 10 minuta për çdo pikë për zotin Muka nuk do e bëjmë.

Denisa Luarasi : Faleminderit.

Flutura Kasa : Të lutem sa më të përmbledhme gjënë. Jo e hap te pika. dy një orë, këtu që duhet me fol tamam don pastaj kohën e plotë, të lutem se.....

Denisa Luarasi: Faleminderit.
Kalojmë në votim. Flutra të lutem.
Me 26 vota pro, 1 abstenim dhe 6 kundër miratohet dhe pika e 16 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 17**, Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë dhe 17-ën ne si komision e votuam pro dhe ftojmë këshillin që t'i japi votën pro sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.
Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave, Tarifave zoti Rolant Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Si pikë shumë në vëmendje të komunitetit, komisioni e kalojë me votë unanime për miratim në këshill bashkiak.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Xhelilaj.
Komisioni i Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë, zonja Mirela Shala.

Mirela Shala. Komisioni i Mbrojtjes Civile miratoi me pro pikën 17 dhe fton këshillin për votim.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Shala.
Komente, pyetje ka për pikën 17?
Kalojmë votim elektronik.
Me 33 vota pro miratohet dhe pika 17 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 18,** Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj

Joniada Musaraj: Edhe 18-ën, edhe 19-ën i kemi votuar pro.

Denisa Luarasi: Pak seriozitet.

Joniada Musaraj: Me radhë. 18-ën e votuam pro dhe ftojmë këshillin që ta miratojë sot.

Denisa Luarasi: Pa seriozitet. Faleminderit zonja Musaraj.
Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave, Tarifave zoti Rolant Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Edhe komisioni jonë me votë unanime e kalon në këshill bashkiak për miratim.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Xhelilaj.
Komisioni i Marrëdhënieve me Jashtë dhe Integrimit Evropian zoti Luan Nezha.
Luan, të lutem thërrit mikrofonin.

Luan Nezha: Përshëndetje.
U mblodh komisioni dhe ne jemi dakort që të kalojë. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Nezha.
Komente pyetje ka për pikën 18?
Nuk ka. Kalojmë votim.
Me 33 vota pro miratohet dhe pika 18 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 19,** Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë dhe 19-ën e votuam pro dhe ftojmë këshillin që ta miratojë sot dhe ta mbyllim mbledhjen. Shumë faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.
Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Marsida Feshti.

Marsida Feshti: Edhe Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort që pika 19 të kalojë për votim në këshill. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Feshti.
Komente pyetje ka për pikën 19?
Nuk ka. Kalojmë në votim.
Me 33 vota pro miratohet dhe pika 19.
Ju falenderoj për angazhimin. Faleminderit.
Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 38 (tridhjetë e tetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga drejtuesja e seancës *(Kryetare e Këshillit Bashkiak), sekretarja i këshillit dhe 3(tre) këshilltarë.*

Mbajtëse e procesverbalit: Loranda Cani

Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :

Drejtuese e seancës (Kryetare e Këshillit Bashkiak) :	DENISA LUARASI
Sekretare e Këshillit Bashkiak :	DORINA MILJA
Këshilltare (Zv/kryetar i Këshillit) :	MIRELA SHALA
Këshilltari (Kr.Grupi) :	ARDIAN MUKA
Këshilltari (Kr. Grupi):	ROLANT XHELILAJ